



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION




Emri i Biznesit: "TelKos" L.L.C.

Numri i Biznesit: 810868995

Përfaqësues: z. Enver BERISHA

OSHMA: TG TV

Adresa: Prishtinë



VENDIM

për ndryshimin e emrit të OSHMA TG TV në TARGET - me seli në Komunën e Prishtinës

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. TG TV është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale i licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave për transmetim të programeve televizive përmes rrjetit të operatorëve të shpërndarjes, në gjuhën shqipe dhe me seli në komunën e Prishtinës. TG TV është pajisur me licencë të KPM-së me datën 3 nëntor 2020, me afat të licencës prej dhjetë (10) vitesh, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për KPM-në.
3. Me datën 11 maj 2021, OSHMA TG TV ka dorëzuar një kërkesë në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, përmes së cilës ka kërkuar miratimin e KPM-së për ndryshimin e emrit nga TG TV në TARGET.

Arsyetim

4. Në pajtim me Nenin 21, paragrafin 7 të Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2017/02), logo/emri i një OSHMA mund të ndryshohet vetëm pas miratimit nga KPM. Pargrafi në fjalë përcakton: *"I licencuari duhet ta identifikojë përmabjtjen e tij me anë të logos, e cila mund të ndryshohet vetëm me miratim paraprak nga KPM-ja."*
5. Komisioni konstaton se KPM nuk ka asnjë të licencuar me emër të njëjtë apo të ngjajshëm me emrin e propozuar për ndryshim TARGET, prandaj ndryshimi i emrit të TG TV në

TARGET nuk do të paraqet pengesa apo konfuzion tek publiku gjatë transmetimit të programeve televizive.

6. Komisioni vlerëson se, kërkesa është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

Vendim

7. Komisioni në takimin e tij, të mbajtur me datën 26 maj 2021, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin emrit të OSHMA TG TV në **TARGET**.
8. Komisioni vendos që, përveç ndryshimit të emrit nuk do të ketë ndryshime në pjesët tjera të Licencës.
9. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat EATIFI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



26.05.2021

datë